



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.73-2/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli, kryesues, Hajriz Hoti dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim Anr.73-4/2025, të subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr.73/2025 të datës 22.01.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 28.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar kërkesa Anr.73-4/2025 e datës 24.01.2025, e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin dhe anulimin e vendimit të PZAP-it, A.nr.73/2025, të datës 22.01.2025, me të cilin i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 1,000.00 euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Paneli me Vendimin Anr.73/2025 të datës 22.01.2025, subjektit ankues i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 1,000.00 euro, në emër të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

PZAP-i, me datë 24.01.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.73/2025 të datës 22.01.2025, nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, me të cilën pretendohet se PZAP-i, nuk ka marrë për bazë gjendjen faktike dhe deklaratimet e z. Berisha dhe pa i vërtetuar faktet dhe deklaratimet ka shqiptuar gjobë për subjektin PLE, me propozimin që pas rishikimit të anulohet vendim Anr.73-2025 dhe gjobën e shqiptuar në shumën 1,000.00 ndaj subjektit të tyre politik.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

Kërkesa për Rishqyrtim dhe anulimin e vendimit A.nr.73/2025, është e pabazuar.

Paneli zgjedhor me rastin e shqiptimit të dënimit subjektit politik PLE me vendimin Anr.73/2025 të datës 22.01.2025, ka gjetur se gjuha e përdorur ndaj subjektit politik IRDK, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP, e duke marrë për bazë kontekstin dhe qëllimin për të cilën është përdorur dhe faktin që deklaratat janë bërë në miting publike dhe audiencën, Paneli ankesën e ka konsideruar si të bazuar dhe ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të vendimit, rishikimi i së cilës kërkohet.

Paneli zgjedhor duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura vendimi i kontestuar me rishikim, rezulton të jetë i drejtë, të ndërtuara mbi fakte, prova dhe të mbështetura në dispozitat ligjore në fuqi, e kjo për faktin se Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, me të cilin përcaktohet se: *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Prandaj, në rastin konkret subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), kërkesën për rishikim të vendimit nuk e ka mbështetur në asnjë provë apo fakt të ri, që do ta bind panelin që të njëjtën kërkesë ta aprovojë si të bazuar, por i ka përsëritur pretendimet si në përgjigjen e dhënë lidhur me ankesën e subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK).

Sa i përket datës 14.01.2025, në të cilën thirret subjekti politik, e që ndërlidhet me ndërmarrjen e hetimeve, Paneli gjen se bëhet fjalë për një gabim teknik dhe nuk ndikon në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo që është marrë në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.73-2/2025, datë; 28.01.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.